



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.38/2018
Prishtinë, më 25.7.2018, në orën 11:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Hykmete Bajrami, Memli Krasniqi, Mimoza Kusari-Lila, Muharrem Nitaj, Bilall Sherifi dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Adem Hoxha, Liburn Aliu, dhe Glauk Konjufca.

E ftuar: Blerta Deliu-Kodra, kryetare e Komisionit për Integritet Evropian.

Pjesëmarrës: Dardan Abazi – INDEP; Blerina Krasniqi – KDI, Liridon Gashi – SEEF dhe Valbona Bytyçi – Ekonomia online .

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha Shala, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 17.7.2018;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-038 për shërbimet postare, pas rekomandimeve të Komisionit për Integritet Evropian;
4. Formimi i grupit punues për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-132 për Automjete;
5. Te ndryshme.

Kryesuesja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetarja propozoi që pika e tretë e rendit të ditës, Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-038 për shërbimet postare pas rekomandimeve të Komisionit për Integritet Evropiane,” të kalojë në pikën e katërt, ndërsa, pika e katërt “Formimi i grupit punues për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-132 për Automjete,” të kalojë në pikën e tretë të rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimin e propozuar nga kryetarja.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 17.7.2018;

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 17.7.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Formimi i grupit punues për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-132 për Automjete

Kryetarja theksoi se pasi që e kemi kaluar në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Automjete, dhe pas dëgjimit publik, tani është procedura e formimit të grupit punues.

Pas propozimeve, Komisioni nxori këtë:

V E N D I M

1. Formohet Grupi Punues për shqyrtimin e Projektligjit nr.06/L-064 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-132 për Automjete;

2. Grupi punues ka këtë përbërje: Muharrem Nitaj, kryesues, Dardan Sejdiu, Mimoza Kusari-Lila dhe Memli Krasniqi, anëtarë;

3. Grupi punues në bashkëpunim me stafin mbështetës të Komisionit, të shqyrtojë projektligjin dhe të përgatisë raportin me shkrim për shqyrtim dhe miratim në Komision.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-038 për shërbimet postare pas rekomandimeve të Komisionit për Integritet Evropiane;

Kryetarja, tha se Komisioni i Përhershëm për Integritet Evropiane, pas afatit të paraparë me Rregulloren të Kuvendit, paraqiti Rekomandimin e tij më 26.6.2018, ku thekson se nuk duhet të miratohen amendamentet e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, më numër 2, 6, 7, 8 dhe 9, me arsyetimin se nuk janë në përputhje me legjislacionin e BE-së. Në seancën plenare të Kuvendit më 12.7.2018, u radhit për lexim të dytë Projektligji nr.06/L-038 për shërbimet postare, por më propozim të Komisionit për Integritet Evropiane, Kuvendi nxori përfundimin se, Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal dhe Komisioni për Integritet Evropiane, duhet ti harmonizojnë qëndrimet dhe Kuvendit t’ia paraqesin Raportin me Rekomandime.

Dardan Sejdiu, tha se para se të diskutohet për pesë amendamentet e kontestuara, me propozim të stafit të Komisionit, duhet të rishikohet edhe njëherë Amendamenti 10, sepse në formën e tillë është i pakuptimtë. Ai tha që dërgesat të mos jenë të limituara sepse nuk ka gjë të keqe me i lënë pa limit, sepse është shërbim i lehtë, dërgesë e thjeshtë, që me rastin e dorëzimit pranimit të dërgesës nuk lëshohet dëshmi. Sejdiu kërkoi që amendamenti 6, të hiqet, të mbetet ashtu siç është në projektligj, ndërsa amendamentet e tjera të Komisionit të mbeten të pandryshuara.

Memli Krasniqi, tha se pajtohet me disa nga ndryshimet e propozuara të Sejdiut, siç është amendamenti 10, sepse ashtu si është, nuk ka kuptim sintaksor. Ne po e bëjmë obliguese kompensimin nga Qeveria, në rast të humbjeve nga shërbimi universal. Tek amendamentet e kontestuara, u pajtua që të hiqet amendamenti 6, sepse krijon një pozitë të disfavorshme për tregun. Mirëpo, për amendamentet tjera duhet të gjendet një gjuhë, që nuk bie ndesh me direktivat e BE-së, dhe harmonizimi me legjislacionin e BE-së është i nevojshëm për të gjitha projektligjet.

Hykmete Bajrami, tha që me këtë riformulim të amendamentit 10, ndoshta projektligji do të duhet të shkojë në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe aty të japin vlerësimin e ndikimit buxhetor. Kur dihet se mbi 50 për qind e të hyrave të postës hyjnë nga qiraja që i merr nga Telekom, çka nëse nesër ose pasnesër privatizohet Telekom. Në lidhje me obligimin që Qeveria të kompensojë humbjet e shërbimit universal, më anë të ndihmës shtetërore, është e vështirë për buxhetin e shtetit, kur ndërmarrja publike për shkak të menaxhimit jo të mirë në vazhdimësi operon me afarizëm jostabil.

Mimoza Kusari -Lila, tha se mund të jetë e rrezikshme për buxhetin e Kosovës kompensimi për humbjet e shërbimeve universale, prandaj duhet të sigurohet që me vlerësim real, Qeveria ia kompenso, për ta mbajtur një shërbim të nevojshëm për shtetin.

Bilall Sherifi, tha se me këtë projektligj do ti ofrohen shumë më shumë mundësi operatorit publik. Po e bëjmë një ligj me të cilin i ofrojmë mundësi më të mëdha Postës së Kosovës.

Blerta Deliu-Kodra, kryetare e Komisionit për Integritet Evropian, tha se për shkak të mungesës së kuorumit, Komisioni i Përhershëm për Integritet Evropian, nuk ka arritur të mbajë mbledhje në afatin e paraparë, për të dërguar rekomandimin në lidhje me këto amendamente. Vota juaj do të vendosë, por qëndrimi i Komisionit për Integritet Evropian është që 5 amendamentet e propozuara nga komisioni juaj, janë në kundërshtim me direktivat evropiane. Deliu-Kodra, edhe njëherë e paraqiti rekomandimin e datës 26.6.2018, dhe kërkoi nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, që të tërhiqen nga amendamentet e kontestuara sepse nuk janë në përputhje me legjislacionin e BE-së.

Kryetarja, potencoi se në këtë mbledhje duhet si komision ta kemi një qëndrim që do ta paraqesim në Kuvend, për raportin me amendamente të Projektligjit për shërbimet postare, pas rekomandimit të Komisionit për Integritet Evropian, për 5 amendamentet e kontestuara.

Pas debatit, Komisioni shqyrtoi amendamentet një nga një, dhe vendosi si në vijim:

*Me 6 (gjashtë) vota “për”, 1 (një) “kundër”,
Amendamenti 2 fshihet.*

*Me 7 (shtatë) vota “për”,
Amendamenti 6 fshihet.*

*Me 6 (gjashtë) vota “për”, 1 (një) “kundër”,
Amendamenti 7 mbetet i pandryshuar.*

*Me 6 (gjashtë) vota “për”, 1 (një) “abstenim”,
Amendamenti 8 ndryshohet si në vijim:
Neni 13, nënparagrafi 2.1., fjalia “me peshë deri në 50 (pesëdhjetë) gramë”, zëvendësohet me
“me peshë deri në 100 (njëqind) gramë”.*

*Me 6 (gjashtë) vota “për”, 1 (një) “abstenim”,
Amendamenti 9 ndryshohet si në vijim:
Neni 13, paragrafi 3, fjalia “së paku 2.5 herë më të lartë”, zëvendësohet me “së paku 3 (tre)
herë më të lartë”.*

*Me 6 (gjashtë) vota “për”, 1 (një) “kundër”,
Amendamenti 10 ndryshohet si në vijim:
Neni 15, paragrafi 7, riformulohet si në vijim:
7. Autoriteti, bazuar në llogaritjet, i përcakton ofruesit të shërbimit universal postar të drejtën e kompensimit për shërbimet universale postare, si dhe përcakton nivelin e kompensimit mbi bazën e kostos neto. Në çdo rast, kompensimi kryhet vetëm pas miratimit nga Komisioni i Ndhmës Shtetërore, sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për ndihmën shtetërore.*

Deputetja Hykmete Bajrami, nuk mori pjesë në votim, edhe pse ishte e pranishme në mbledhje.

Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Raporti plotësues në lidhje me amendamentet e propozuara në Projektligjin nr.06/L-038 për Shërbimet Postare t'i procedohet Kuvendit dhe të kërkohet që Projektligji të radhitet si pikë shtesë e seancës së datës 26.7.2018.

5. Të ndryshme. Çështjet vijuese.

Diskutim lidhur me Projektligjin nr.06/L-033 për Produkte të Ndërtimit

Memli Krasniqi, kërkoi sqarime lidhur me Projektligjin për Produkte të Ndërtimit se si të vepohet, a të procedohet për seancë në Kuvend apo t'i kthehet Qeverisë.

Hykmete Bajrami sqaroi se ka bërë një kërkesë në Drejtorin e Hulumtimeve të Kuvendit për t'u informuar se si është e rregulluar çështja e produkteve të ndërtimit me legjislacionin e shteteve të rajonit. Siç jeni të informuar deri në vitin 2012, Departamentit Ndërtimit ka qenë në Ministrinë Tregtisë dhe Industrisë dhe pastaj ka kaluar me gjithë stafin, duke përfshirë kompetencat dhe përgjegjësitë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ku gjendet edhe sot. Ajo tha se problemi është së projektligji parasheh që duhet të krijohen trupa për inspektim, por që ky departament tani gjendet në MMPH dhe nëse duhet të kemi standardet për produkte të ndërtimit atëherë duhet të vendosim se ku ti kemi këto trupa inspektuese, në kufi, në doganë, ku hyjnë shumica e këtyre produkteve ndërtimore ose të kemi një laborator shtetëror për kontrollin e standardeve të produkteve të ndërtimit. Në fund, Bajrami theksoi se tërhiqet nga kryesuesja dhe anëtarja e grupit punues për këtë projektligj dhe propozoi që projektligji ti kthehet Qeverisë.

Bilall Sherifi, theksoi se pas arsyetimit që kanë dhënë përfaqësuesit Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, ky projektligj duhet të procedohet më tutje, të shkojë në seancë dhe le të vendosë Kuvendi.

Kryetarja, propozoi që edhe për këtë çështje të veprohet në bazë të procedurave që janë në Rregulloren e Kuvendit.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë:

V E N D I M

Ndryshohet Vendimi Nr.8-VI-2018, datë 6.3.2018, ndryshuar më datë 3.7.2018, për grupin e punës për shqyrtimin e Projektligjit për produkte të ndërtimit, si në vijim: Mimoza Kusari- Lila, kryesuese, Liburn Aliu dhe plotësohet me përfaqësuesin e GP Nisma.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Sala BERISHA SHALA